FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 53	2002	Gusht

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.400, datë 22.8.2002	Për arsimimin, cilësitë profesionale dhe përvojën në punë të kandidatëve që do të punësohen në funksione që kërkojnë njohuri të posaçme, administrative, teknike e shkencore, në Policinë e Shtetit……	1535

V E N D I M
Nr. 400, datë 22.8.2002

PËR ARSIMIMIN, CILËSITË PROFESIONALE DHE PËRVOJËN NË PUNË TË KANDIDATËVE QË DO TË PUNËSOHEN NË FUNKSIONE QË KËRKOJNË NJOHURI TË POSAÇME, ADMINISTRATIVE, TEKNIKE E SHKENCORE, NË POLICINË E SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 21 të ligjit nr.8643, datë 20.7.2000 "Për gradat në Policinë e Shtetit", me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kandidatët, që do të punësohen në funksione të cilat kërkojnë njohuri të posaçme administrative, teknike e shkencre, në Policinë e Shtetit, duhet të plotësojë kriteret arsimore, për të cilat janë diplomuar ose kanë certifikatë të kualifikimit të lartë, të barasvlefshme me diplomën si më poshtë vijon:

a) Në strukturat mbështetëse:

- për strukturat e personelit, të jetë diplomuar: punonjës social, sociolog, jurist apo ekonomist;
- për strukturat e financës e të kontrollit financiar, të jetë diplomuar ekonomist.
- për strukturat e logjistikës e të teknikës, të jetë diplomuar për prapavijën, armatimin, automekanikën ose të jetë diplomuar inxhinier a ekonomist;
- për strukturat e telekomunikacionit, të jetë diplomuar në ndërlidhje ose në elektronikë;
- për strukturat e profilaksisë e të mjekimit, të jetë diplomuar mjek;
- për strukturat e statistikës, të jetë diplomuar ekonomist.

b) Në strukturat operuese:

- për strukturat e luftës ndaj krimit ekonomik e financiar, të jetë diplomuar ekonomist.
- për strukturat e përpunimit të të dhënave dhe gjurmimit teknik, të jetë diplomuar në informatikë ose elektronikë;
- për strukturat e shkencave ligjore, të jetë diplomuar në shkencat e natyrës, të jetë diplomuar mjek ose në specialitete të tjera, të disiplinave përkatëse.

2. Pas përfundimit të konkurrimit, fituesi pranohet dhe kryen kursin përkatës të kualifikimit policor, sipas afateve të përcaktuara në aktet, ligjore e nënligjore, në fuqi.

3. Ngarkohet Ministria e Rendit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrën së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:
- Kodi Penal (të azhornuar)
- Kodi i Procedurës Penale (të azhornuar)
- Kodi Civil (të azhornuar)
- Përmbledhje të Legjislacionit në fushën e transporteve (Kodi Rrugor dhe ligji për transportet) (të azhornuar)
- Kodi Zgjedhor (të azhornuar)

U dorëzua për shtyp më 30. 8. 2002
Doli nga shtypi më 30. 8. 2002

Tirazhi: 4250 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 50 lekë